



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.104 dt.28.09.2001

**MBI  
KALIMIN KAPITAL TE MAKINERISE**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, kreu i parë, neni 4, pika 3, V.K.M. nr.153 dt.04.03.1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” pika 1, 2 gërma d, V.K.M. 378 dt.12.08.1999 “Për kalimin e së drejtës së përfaqësuesit të pronarit për disa objekte pronë publike, organeve të qeverisjes vendore” pika 1 nr. në listë 40,53, V.K.M. nr.8 dt.13.01.2001 “Për një shtesë në V.K.M. 378, dt.12.08.1999”, në listën 55 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Të miratojë kalimin e furrës me induksion nga Uzina Mekanike Tiranë në Uzinën e Pjesëve të Ndrimit për Automjete
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe dy ndërmarrjet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**



